Qarkullonte me pistoletë/ Arrestohet 39-vjeçari

21 JANAR 2026, 08:42, KRONIKA
CNA

Në vijim të goditjeve të njëpasnjëshme kundër armëmbajtjes pa leje, bazuar edhe në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas qarkullonte me automjet, i armatosur me armë zjarri, shërbimet e Komisariatit të Policisë Kavajë kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Drawer".

Në kuadër të operacionit, në lagjen nr. 1, Kavajë, shërbimet e Policisë kanë konstatuar dhe ndaluar për kontroll automjetin që dyshohej se drejtohej nga një shtetas i armatosur me armë zjarri.

Gjatë kontrollit të imtësishëm të automjetit, shërbimet e Policisë i gjetën të fshehura në një ndarje të posaçme (sirtar) ndërmjet dy sediljeve të automjetit një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Q. B., 39 vjeç, banues në Durrës.

Gjithashtu, nisi procedimi penal për pasagjerin që ndodhej në automjet, shtetasin E. B., 33 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzim i krimit"./ **CNA**

Lajmet e fundit nga Denoncim | Vetingu | Kronika | Sociale | Kosova & Bota | Kulturë | Ekonomi

16:50
Emërim i kontestuar në Aeroportin e Vlorës/ Çfarë po ndodh mes kompanisë koncensionare dhe administratorit të ri?

14:53
Skandaloze/ Turpi ndaj personelit shëndetësor, nuk u jepen pagat

13:21
Dokumenti/ Agim Ismaili "përmbyti" burgjet me ilaçe të skaduara

10:08
Projektues të papërgjegjshëm dhe pasoja të rënda/ Rruga Qukës-Qafë Plloçë, si simbol i paaftësisë profesionale